

Formular Syllabus – Pikturë 2

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arteve
Departamenti	DAD - DIZAJN SKENE DHE KOSTUMOGRAFI
Titulli i lëndës:	Pikturë 2
Niveli:	<u>Bachelor</u>
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti: II, Semestri III – IV
Numri i orëve në javë:	L. 3 (tre), U. 1 (një)
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	E hënë: 8:30-10:45
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.asst.dr. Zeni Ballazhi
Detajet kontaktuese:	+383 44 200 219 zeni.ballazhi@uni-pr.edu

Përshkrimi i lëndës	<p>Kompozicione abstrakte, figurë në atelie me model dhe krijimi i koncepteve sipas shkrimeve të një skenari për teatër apo filmi artistik.</p> <p>Komponohet me skicime dhe drejtpërdrejt në pikturë me materiale sipas konceptit, njihet me mënyrën e vendosjes në harmoni të objekteve studiuese për pikturë, të kompozicionit, formave, planeve dhe vështrimet reale të objekteve dhe materializimi i objekteve. Punohet me çdo student veç e veç gjatë studimit; praktik-teori, vërejtje, këshilla, sugjerime etj. lidhur me natyrën e realizimit sa më të suksesshme të punës.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Njoftimi i studentëve me nevojat e materialit të lëndës së pikturës për vitin e dytë.</p> <p>Paisja me njohuritë e nevojshme teknologjike lidhur me pikturën si medium i ri në artin modern dhe punën me artistë të kësaj fushe në mënyra, kohëra dhe hapësira të ndryshme. Njohurit teknike dhe profesionale të pikturës analizuar nga qasje të ndryshme të kritikve e analisteve të dëshmuar në botë.</p> <p>Materialet e nevojshme; ngjyra akril ose të vajit, brusha speciale për teknikat e caktuara, letër speciale ose pëlhurë të gatshme, te përgatitur për fillimin e punës dhe paisjet tjera teknike.</p> <p>Njoftim me mënyrën e punës dhe përdorimin me</p>

	<p>teknikat e pikturimit përmes teknikave të shumta për realizim.</p> <p>Studentët punojnë drejtpërdrejt me ngjyrë sipas koncepteve dhe skicave paraprake.</p> <p>Skicat e shpejta (që shkathtësojnë studentët në kapjen e shpejtë të ideve kompozicionale dhe figurës përmes së cilave perfeksionojnë linjat më të çliruara dhe avancimi i studimit.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Me këtë nivel studentët e nivelit BA do të marrin informacionin e duhur rreth pikturës si praktikë (zanatë) si dhe historisë së pikturës për pjesën e artit dramatik. Zhvillimi i aftësisë kompozicionale.</p> <p>Do të mësojnë rrjedhën e punimeve të pikturve modern në epoka kohore në mënyrë kronologjike dhe nëpër zhanre të ndryshme të pikturës.</p> <p>Do të mësojnë për të arriturat teknologjike të pikturës klasike dhe moderne në mënyrë kronologjike sipas historisë së artit.</p> <p>Aftësia e studentit në vlerësimin e punës, apo vetëvlerësimi për të arriturat profesionale si dhe analizë, kritikë dhe debat rreth punës.</p>

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënimit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	30 Javë	90
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kolokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë	1	30 Javë	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim	5	3 Javë	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezantimet ,etj	5	3 Javë	15
Totali			150

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Puna praktike dhe teorike në klasë. (ligjërata, punë praktike, seminar, diskutim, skicim, punë individuale, punë në grupe, projeksione fotografike) kontrollimi i detyrave të punuara nga studenti brenda dhe jashtë fakultetit. Leksione- ligjërata për analize, kritikë, diskutim, lexim apo demonstrim të materialeve të ndryshme të artit në lidhje me specifikën e lëndës. Zhvillimi dhe provokimi i debatit..</p>		
Metodat e vlerësimit: Sistemi i vlerësimit me pike	<p>Mënyra e notimit: Rregullshmëria në ligjërata Rregullshmëria në ushtrime Kolokviumi / analiza dhe vlersimi Punë individuale Punë praktike (prezantim i projektit)</p> <p>Nën <50 pikë – vlerësohet me notë jo kaluese >50 – <60 pikë – vlerësohet me notën (6) >60 – <70 pikë – vlerësohet me notën (7) >70 – <80 pikë – vlerësohet me notën (8) >80 – <90 pikë – vlerësohet me notën (9) >90 pikë – vlerësohet me notën (10)</p> <p>Vlerësimi i parë: 20% Vlerësimi i dytë: 30% Vijimi i rregullt: 10% Provimi final: 40% Totali; 100%</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<p>Histori e artit botëror dhe atij vendor. Analizë autorëve të ndryshëm. Informacione nëpërmjet medimeve të ndryshme për të rejtat në artin figurativ gjegjësisht në mediumin pikturë. Autorë, kurator, artist, historian, kritikë e analistë të artit konceptual, varësisht nga qasja individuale e studentit. Informacione kronologjike sipas historisë. Informacioni bazë nga biblioteka e Fakultetit të Arteve, nga autori; E.H.Gombrich, The Story of Art, botimi në shqip Soros; Marija Besinova, „ Art Today nga Edwar Lucie-Smith, Historia e Artit Modern nga H.H. Arnason etj.</p>		
Literatura shtesë:	Literaturë për artistët figurativ modern. Histori e		

	<p>artit botëror dhe atij vendor të autorëve dhe piktorve të ndryshëm. Botimet e Galerisë Kombëtare të Kosovës dhe institucioneve nga rajoni dhe bota si monografi, katalogje dhe revista.</p>
Plani i dizajnuar i mësimi: Viti i Dytë (Semestri i Tretë)	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezantimi i lëndës. Diskutim mbi planprogramin e lëndës, rrjedhen e ligjeratave dhe bibliografine e nevojshme. Trajtimi i temave dhe motiveve.
Java e dytë:	Projektimi i lëndës “Pikturë 2”. Pikturimi tonik; natyrë e qetë dhe kompozicioni abstrakt Vazhdim i punës praktike dhe sugjerime
Java e tretë:	Pikturim me ngjyra; natyrë e qetë dhe kompozicion abstrakt Diskutim për kolorin gjatë punës praktike
Java e katërt:	Analizë e punës rreth pikturimit tonik dhe kompozicionit abstrakt Analizë e punës rreth pikturimit me ngjyra dhe kompozicioni
Java e pestë:	Pikturimi abstrakt i kompozicionit sipas ideve dhe eseve përshkruese me një ngjyrë; të ujit apo temper Interpretim ngjyrash në studimin e kompozicionit abstrakt
Java e gjashtë:	Studimi i figurës abstrakte-pikturë sipas modelit Studim akademik – analitik (teori-praktik)
Java e shtatë:	Natyrë e qetë dhe kompozicion abstrakt – variacioni i toneve dhe ngjyrave –vazhdim nga ora e kaluar
Java e tetë:	Kompozicione abstrakte sipas temave nga drama dhe filmi Analizë dhe vërejtje në vazhdimësi të punimit; prof.-student
Java e nëntë:	Perspektiva lineare në natyrë të qetë përmes ngjyrës Studim gjatë punës me student
Java e dhjetë:	Kompozicione tematike (individuale) Vazhdim nga ora e kaluar
Java e njëmbëdhjetë:	Kompozicione tematike (grupore) Vazhdim nga ora e kaluar
Java e dymbëdhjetë:	Analizë rreth materializimit të figurës me kompozicionin abstrakt Vazhdim i punës nga ora e kaluar
Java e trembëdhjetë:	Kompozicione ngjyrash sipas imagjinatës dhe tematikave Vazhdim i punës nga njësia e kaluar
Java e katërmëdhjetë:	Analizë dhe kritikë individuale dhe grupore e punës së kompozicionit dhe figurës (problemet e pozitës së shtrirjes

	së pozitës së portretit dhe figurës kompozicionale Natyre e qetë dhe problemet e perspektivës -analizë
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi i punës semestrale; kritikë dhe analizë

Plani i dizajnuar i mësimi: Viti i Dytë (Semestri i Katërt)	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Kontrasti i elementeve në natyrë të qetë dhe kompozicion Figura me elemente të tjera si shprehje qenësore
Java e dytë:	Harmonia e ngjyrave në kompozicion abstrakt Harmonia e formës në hapësirë përmes ngjyrës
Java e tretë:	Konkretizimi material dhe kompozicional i punës Problemet e kompozicionit, diskutim dhe analizë nga ora e kaluar
Java e katërt:	Pikturimi sipas imagjinatës (temë e lirë) Vazhdim nga ora e kaluar, diskutim, vërejtje, bashkëbisedim
Java e pestë:	Figura në kompozicionin imagjinues Vërejtje, sugjerime, diskutime rreth punës nga ora e kaluar
Java e gjashtë:	Variacione ngjyrash në pikturë abstrakte (teori-praktik) Bashkëbisedim për temën nga ora e kaluar
Java e shtatë:	Kompozicioni me elemente të tjera abstrakte dhe figurative Vazhdim i punimit nga ora e kaluar
Java e tetë:	Kompozicioni në figurë dhe elemente të tjera Kontrasti i ngjyrës në kompozicion (teori-praktik)
Java e nëntë:	Përfundimi i punimit Studim dhe analizë nga ora e kaluar
Java e dhjetë:	Studimi i valerit në pikturë abstrakte (kompozicion) Vazhdim nga ora e kaluar
Java e njëmbëdhjetë:	Kompozicion sipas imagjinatës Vazhdim i punës nga ora e kaluar
Java e dymbëdhjetë:	Kompozicion me forma të çrregulluara Analizë dhe studim i kompozicionit
Java e trembëdhjetë:	Vizitë; Galerisë Kombëtare të Kosovës, Diskutim i lirë dhe analizë rreth punëve të ekspozuara
Java e katërmëdhjetë:	Analizë dhe kritikë individuale dhe grupore rreth punës së përfunduar brenda vitit
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezentimi final i fundvitit i të gjitha prezenteve teorike dhe praktike të parashtruara për provimin final. Vlerësimi dhe përgatitja e punimeve për organizimin e ekspozitës

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Ardhja 15 minuta për përgatitje para orarit të përcaktuar të mësimit.

Fikja e telefonave celularë

Mbajtja e pastërtisë dhe e qetësisë në mësim.

Zbatimi me korrektësi i orarit të fillimit dhe mbarimit të mësimit